



P R O C E S V E R B A L I

Mbledhja e Komitetit për Komunitete e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur me datë: **31.10.2022** me fillim në ora **10.00**. Këtë mbledhje e kryesoi kryesuesi i komitetit për komunitete **z. Bajram Morina**.
Kryesuesi – Fillimisht më lejoni t’ju përshëndes të gjithëve për praninë tuaj, përshëndetje për shefin e Zyrës për Komunitete dhe Kthim **z.Lendrit Qeli**, përfaqësuesit të OSBE-së – UNMIK-ut si dhe përfaqësuesit të LMT-së. Ky është takimi i pestë për vitin 2022, për takimin e sotëm i kemi këto pika të rendit të ditës:

R E N D I T E

1. **Aprovimi i procesverbali nga mbledhja e kaluar;**
2. **Informatë rreth dëmeve të shkaktuara nga vërshimet e fundit në vendbanimet ku jeton komuniteti joshumicë;**
3. **Informatë rreth qendrës mësimore – shkollës fillore të mesme të ulët “Katër dëshmorët” në Ratkoc;**
4. **Informatë nga ZKK-ja;**
5. **Të ndryshme;**

Kryesuesi – Atëherë e vendosim në votim rendin e ditës, kush është për?... kundër?... abstenim?... Atëherë konstatoj që unanimisht është aprovuar rendi i ditës.

1. Aprovimi i procesverbali nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi – A ka dikush ndonjë vërejtje rreth procesverbalit?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim, kush është për?... unanimisht është aprovuar pika e parë e rendit të ditës.

2. Informatë rreth dëmeve të shkaktuara nga vërshimet e fundit në vendbanimet ku jeton komuniteti joshumicë;

Skender Hamza – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Në mungesë të zyrtarit i cili është dashur të raportoj, por mungon për shkak të një rasti të vdekjes. Unë do t’ju jap disa informata rreth kësaj pika; Nga dëmet e shkaktuara në vërshimet e fundit, kryetari i komunës e ka formuar menjëherë një komision i cili ka dalë në terren për vlerësimin e rasteve. Sipas këtij komisioni, dëmet e shkaktuara nga komuniteti joshumicë janë: Në Ratkoc 1 rast, në Xërxe 1 rast, në Celinë 3 dhe në qytet në Rahovec 1 rast. Dëmet kapin shifrën e mbi 1 milion eurove në përgjithësi. Raporti është dërguar në ministrinë përkatëse, i presim kompensimet.

3. Informatë rreth qendrës mësimore – shkollës fillore të mesme të ulët “Katër dëshmorët” në Ratkoc;

Avni Morina – Faleminderit. Të nderuar të pranishëm, përfaqësues nga zyra e komuniteteve përfaqësues nga OSBE-së dhe LMT-së. Qendra arsimore që funksionon në shkollën “Katër dëshmorët” në Ratkoc është e themeluar me vendim të ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë dhe funksionon bazuar në udhëzim administrativ që nga viti 2020. Kjo qendër ka funksionuar edhe para këtij vendimi, mirëpo prej fillimit të vitit 2020 është zyrtarizuar. Për funksionimin e kësaj qendre, kontribut të veçantë ka dhënë edhe organizata “Zëri i Romëve, Ashkalinjëve dhe Egjiptianëve” e cila vazhdon të ketë marrëveshje

bashkëpunimi me DKA-në për të përcjellur funksionimin e kësaj qendre arsimore. Ne kemi qenë edhe për vizitë unë si drejtor me ekipin e DKA-së dhe vazhdimisht e kemi përcjellur mirëfunksionimin e kësaj qendre. Në këtë qendër arsimore janë të 23 nxënës të të gjitha komuniteteve pa dallim dhe aty mbahet mësim shtesë, jo mësim i rregullt siç orari mësimor i klasave. Kryesisht janë të komuniteteve joshumicë; 14 Egjiptianë, 2 Ashalinjë, 5 Shqiptarë dhe për nga përbërja e kësaj qendre lirisht mund të themi që është multietnike. Këta nxënës përveç që kanë dallime etnike, kanë dallim edhe për nga mosha sepse ka nxënës që janë nga klasa e parë, parashkollë, nga klasa e parë deri në të nëntën. Sipas cikleve; I ulët i ka 13 nxënës 7 prej tyre të gjinisë mashkullore dhe 6 të gjinisë femrore. Cikli i lartë ka 10 nxënës, 5 të gjinisë femrore dhe 5 mashkullore. Gjatë këtij viti në bashkëpunim me OJQ-në “V.O.RAE” dy tutorë që japin mësim në këtë qendër arsimore, deri në fund të muajit gusht janë financuar nga organizata sipas një marrëveshje. Ndërsa për 4 muaj të tjerë pagesa e tyre do të bëhet nga DKA-ja. Sipas marrëveshjes që e kemi me ministrinë e arsimit, pas vitit të tretë të themelimit të gjitha kompetencat për përcjelljen e mbarëvajtjen e procesit arsimor do t’i kalojnë DKA-së. Nga janari 2023 të gjitha kompetencat do të kalojnë në DKA. Natyrisht të gjitha ndihmat e të gjithëve janë të mirëseardhun përfshirë këtu edhe ojQ-në “V.O.RAE”. Mund të ketë interpretime të ndryshme nga njerëzit të caktuar që nuk ia dëshirojnë të mirën edukimit. Kam dëgjuar kinse këta dy tutorët po bëjnë një lloj sistemi paralel, etj... Ju siguroj të gjithëve që kjo qendër arsimore është qendër e themeluar me vendim të MASHT-it në përputhje të plotë me UA -2019. Sfidë për DKA-në është që akoma deri më sot nuk kemi arritur që të sigurojmë dy vende për këta dy mësimdhënës që të futen në listën e pagave nga ministria e financave. Patjetër që si DKA do të kërkojmë që këta dy tutorë të përfshihen në listën e pagave si çdo mësimdhënës tjetër i komunitetit shumicë. Gjatë kësaj periudhe kemi patur edhe një donacion për qendrën arsimore nga organizata “Betany Cristian” – Gjakovë, e cila ka furnizuar qendrën arsimore me material didaktik dhe çanta për nxënësit aty. Donacioni është mbështetur nga zyra e UNMIK-ut në Prishtinë. Si drejtor i DKA-së jam i përkushtuar që në të ardhmen e afërt ta themelojmë edhe një qendër arsimore për komunitet pakicë në lagjen epërme të qytetit dhe shpresojmë të gjejmë mirëkuptim edhe me ministrinë e arsimit.

Shqipe Kryeziu – Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë. Desha ta falënderoj drejtorin e arsimit rreth informatës që na dha, ka qenë shumë i kjo. Një kërkesë; Nëse është e mundur këtë informatë të na sjellë në mënyrë elektronike apo fizike dhe paraprakisht çdo informatë tjetër të na bashkangjitet në material me pikat e rendit të ditës.

Faton Ramadani – Përshëndetje i nderuari kryesues, drejtor i DKA-së, ju asambleistë dhe të gjithë të pranishëm. Drejtor, faleminderit që keni gjetur kohë për këto informata, mendoj që informatat ishin të mira dhe shumë voluminoze. Rreth kësaj teme disa pyetje; A kanë mundësi që nxënësit të shkollave tjera të fshatrave tjera që kanë vështirësi në të nxënë të këtij komuniteti të shkojnë në atë qendër dhe ta ndjekin programin për mësimnxënie. Edhe a munden ata dy mësimdhënës që janë të punësuar që t’ju përgjigjen kërkesave dhe nevojave të gjithë nxënësve që janë nga parashkollë deri në klasën e nëntë kur dihet që programet ndryshojnë.

Avni Morina – Faleminderit për pyetjet; Shqipe Kryeziu, thjesht nuk e kam ditur që duhet sjellë në mënyrë elektronike se është një çështje e thjeshtë që kryhet për pak minuta. Jam plotësisht dakord dhe jam i gatshëm që raportet dhe informatat t’i sjelli para mbajtjes së mbledhjes. Pyetja e Faton Ramadani; Qendra arsimore në Ratkoc është për nxënësit e komuniteteve dhe tutorët janë në dijeni sesa nxënës janë aty, nuk përjashtohen edhe fëmijët e fshatrave tjerë. Por zakonisht kjo qendër merret me nxënës që kanë ngecje në mësim ose në ndonjë aspekt tjetër pedagogjik. Tutorët janë të kualifikuar me përvojë të realizojnë mësimin shtesë me të gjitha gjeneratat aty pa asnjë ankesë. Problemi qëndron te dukuria e ndërprerjes së shkollës dhe duhet bërë disa fushata vetëdijësuese sepse është realitet braktisja në fillore dhe në të mesme. Nëse është nevoja ne i vizitojmë edhe familjet e tyre t’i ftojme në takime në mënyrë që fëmijët e tyre të vazhdojnë

shkollimin edhe në universitet. Është befasuese dhe e dhimbshme që prej 169 bursave që i kemi ndarë për studentë për këtë vit, prej komuniteteve joshumicë ka qenë vetëm 1 student përfitues.

Faton Ramadani – Edhe diçka që vet e the që nxënësit e këtij komuniteti përveç nuk vazhdojnë mësimin në shkollë të mesme e ndërprejnë në shkollë fillore. Por a ka ndonjë rast që drejtorja e arsimit ka marrur masa lidhur me këtë dukuri dhe a ka patur sukses drejtorja në këtë aspekt.

Kryesuesi – Drejtor, a mund të ndërlihem unë pasi që unë veproj në atë qendër mësimore. Faleminderit. Z. Faton në atë qendër mësimore janë 23 nxënës. Gjatë funksionimit të qendrës para 4 viteve, kemi patur raste kur disa nxënës e kanë ndërprerë mësimin, mirëpo në bashkëpunim me mekanizma tjerë kemi arritur t'i rikthejmë ata nxënës në procesin mësimor e që sot ata kanë përfunduar gjimnazin, disa të tjerë janë regjistruar në fakultet apo në gjimnaz në drejtimin mjekësi. Ky konsiderohet sukses që ka arritur qendra mësimore në bashkëpunim me bashkëpunim me DKA-në.

Avni Morina – Desha ta informoj z. Faton Ramadanin dhe të gjithë të pranishmit që në kuadër të DKA-së funksionon ekipi për parandalimin e braktisjes dhe mosregjistrimit të nxënësve në shkolla. Ky ekip e ka për detyrë me mundësitë e veta ta parandaloj mosregjistrimin. Ky problem nuk ekziston te komuniteti joshumicë, është bërë problem global për vendet siç është Kosova dhe vendet e Ballkanit. Jemi dëshmitar të faktit që sipas statistikave dallimi prej vitit të kaluar në krahasim me sot është që rreth 400 nxënës i kemi më pak për arsye të ndryshme, të procesit të migrimit jashtë vendit, si dhe të rënies së natalitetit.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor. Deshta ta bëjë edhe një falënderim për përfaqësuesit e zyrës UNMIK-ut në Prishtinë, z. Abedin Lataj dhe Ajshe Çelaj për bashkëpunimin me qendrën arsimore “Betany Cristian” dhe drejtorin që vepron në atë qendër z. Berat Thaqi i cili na ka përkrahur me 22 çanta shkollore dhe me material përcjellës didaktik. Faleminderit edhe prej drejtorit të DKA-së i cili vazhdimisht na jep mbështetje si dhe koordinatori i qendrës arsimore z. Jeton Krasniqi. E kam një brengë jo aq të madhe që me kalimin e kohës do ta kuptojnë gjithë menaxhmenti i shkollës ku unë punoj, pas leximit të udhëzimit administrativ do ta kuptojnë se si funksionon qendra mësimore në Ratkoc.

Avni Morina – I nderuari kryesues, ju e keni shumë lehtë të ngrisni nivelin e bashkëpunimit me menaxhmentin e shkollës. Përkrahjen time e keni si DKA për çdo paqartësi.

4. Informatë nga ZKK-ja;

Lendrit Qeli – Faleminderit kryesues, i nderuar drejtor, të nderuar të pranishëm. Meqenëse është vetëm informatë do të tregoj një përmbledhje të shkurtë për punën e Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim. Tema e fundit që diskutuam ishte për arsimin, më lejoni të jap disa informata te kjo pjesë; Konsideroj që ka patur sukses edhe mbështetja me bursa për nxënësit e shkollave të mesme, sidomos nga radhët e komuniteteve joshumicë. Ne kemi asistuar në 7 nxënës në aplikimin për bursa përmes sistemit E-Kosova që ka qenë goxha i komplikuar, por që për ne ka qenë shumë e rëndësishme t'i motivojmë të rinjtë për aplikim sidomos nxënësit e komunitetit joshumicë. Sa i përket qendrave të komuniteteve; Përpos udhëzimit administrativ ne jemi në dijeni që qendrat edhe licencohen, e kanë në etapë ekstra që nënkupton që kalon nëpër shumë filtra dhe nuk i jep hapësirë dikujt që ta quaj paralele. Qendrat nuk e kanë qëllimin të krijojnë klasë segregative me komunitete që pa dyshim që edhe ne si zyre do të kishim reaguar. Qëllimi i qendrës është që nxënësit ta mbërrijnë hapin në mënyrë të barabartë me mësim, me sensibilizim, me fushata të ndryshme edukuese, rekreative, kulturore etj... Ditëve në vazhdim është në plan të vazhdohet edhe me një qendër tjetër në lagjen e epërme në shkollën “Gëzim Hamza”- Piktori për të cilën dje e ka pranuar një informatë nga zyrtari i IOM-it që është në fazën finale të funksionalizimit, ku më pas do ta nënshkruajmë marrëveshjen edhe me kryetarin. Kam kërkuar ta kemi të mundshëm një takim me ministren në mënyrë që procesin e licencimit ta bëjmë pak më shpejtë, meqenëse edhe donatori po kërkon që kjo të arrihet sa më shpejt që është e mundur dhe besoj që do ta kemi një përgjigje prej ministrisë së nivelit qëndror dhe të paktën prej vitit tjetër qendra të jetë funksionale me të gjitha pajisjet dhe aparaturat. Sa i përket fushave tjera,

këto ditë procesi i tenderimit është në fazën finale sa i përket renovimit të shtëpive dhe besoj që sot ose nesër do të fillojmë me shpërndarjen e materialit. Janë përgatitur të gjitha detajet e projekteve të procesit të renovimit dhe besoj që deri në fund të nëntorit të gjitha renovimet e parapara do të përfundojnë. Këtu përfshihen edhe dy shtëpi me 60m katror, njëra në Lagjen e Epërme, tjetra në Xërxe, kjo e fundit ka qenë kërkesë e asambleistes Edona. Një pikë tjetër që ka të bëjë me shëndetësinë edhe këtu kemi punuar shumë me fushata vetëdijësuese rreth vaksinimit të fëmijëve sidomos për fëmijët të cilën nuk janë vaksinuar pothuajse asnjëherë, ky është një program i UNICEF-it në bashkëpunim me organizatën Balkan Sunflowers. E fundit është ajo që dy plane të veprimit i kemi në proces që kanë të bëjnë ekskluzivisht me zyrën tonë, e para ka qenë jo edhe shumë adekuate për zyrën por që kemi qenë të gatshëm të kontribuojmë; Ka qenë programi i banimit social për 2022-2025 që në takimin e fundit është aprovuar paravësisht që kemi marrur një koment që ta ndërrojmë vitin në favor të komunës. Ndërsa dy plane tjera të veprimit priten të vijnë në asamble; Plani për riatdhesim dhe tjetra me kthim të qëndrueshëm.

Tani e tutje zyra komunale për komunitete dhe kthim nuk do ta ketë vetëm riatdhesimin dhe kthimin e qëndrueshëm por do t'i shtohet edhe një barrë tjetër që ka të bëjë me persona të huaj që mund të vijnë nga flukset të ndryshme nga Azia dhe që ende nuk kemi një koordinim adekuat me ministrinë e punëve të brendshme sepse unë kam ngritur shqetësimet e mia për kapacitetet që i kemi për t'i trajtuar këto çështje.

5. Të ndryshme;

Ramë Berisha – Përshëndetje për të gjithë pjesëmarrësit këtu në sallë, përshëndetje edhe për udhëheqësinë që e kemi. Do të ndalem në dy pika; Vërshimet e fundit që janë bërë paraqesin rrezik nëse përroi në Lugë Xërxe mbeten në gjendjen e tanishme. I lus organet kompetente që ta gjejnë një zgjidhje, ta pastrojnë, ta rregullojnë atë rrugë nëpër të cilën kalon ajo sasi e madhe e ujit që eventualisht mos të bëjë dëme në vendbanime. Në vitin 2016 janë bërë vërshime të vazhdueshme, konkretisht në vendbanimin tim ka hyrë uji, është bërë intervenimi edhe pse me vonesë. Tani përsëri është e nevojshme të bëhet një rehabilitim i terrenit aty për siguri të vendbanimeve dhe fushave. E dyta; e kam një kërkesë për Zyrën për Komunitete dhe Kthim. Për dimrin që po vie, mundësisht të na ofroj ndonjë stuffë për ngrohje sepse parashihet ftohë i madh, njëkohësisht reduktime të rrymës.

Lendrit Qeli – Sa i përket pyetjes së parë, do ta adresojmë te drejtoria përkatëse për pastrimin e asaj përroce. Pyetja e dytë; Ju e dini që Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim për dallim nga komunat tjera ka buxhet vetëm për investime kapitale dhe fatkeqësisht mbështetja e tillë nuk konsiderohet investim apo mbështetje kapitale. E kemi bërë një kërkesë te kryetari i komunës dhe te drejtoria e financave që të shihet një modalitet të ngjashëm me komunat të tjera që zyra jonë për shkak të specifikave dhe kërkesave të ndryshme që ballafaqohet të ketë edhe subvencione dhe përmes tyre e kemi shumë më lehtë të gjejmë lëvizje buxhetore në përputhshmëri me kërkesat e qytetarëve.

Skender Hamza – Përshëndetje. Po ndërlidhem me propozimin e Shqipes. Sa i përket materialit unë pajtohem plotësisht me Shqipen. Ne si sekretari ajo që na vie e servojmë te anëtarët e kuvendit, në këtë rast i propozoj kryesuesit që para se t'i bëjë pikat e rendit të ditës, të vijnë me material te ne duke e bërë rendin e ditës bashkangjitur me material i cili më pas përcillet nëpër e-mailat e juaj.

Shqipe Kryeziu – Te pika e 4-të të mbështetja e bursave në arsim. Më herët kam kërkuar që të dalim në terren me asambleistat dhe t'i hasim nxënësat. Kemi hasur në vesh të shurdhër, mund të them tek ju kryesues. Te mbështetja e bursave për arsim, si kish qenë e mundur që më herët t'i njoftoni ata nxënësa të aplikojnë e mos t'i humbin afatet e aplikimit. Ka qenë dita e fundit kur unë vet personalisht i kam njoftuar 4 nxënësa në shkollë e mesme të lartë "Ukshin Hoti" që mund të aplikojnë për bursa sepse ata nuk kanë qenë të njoftuar fare për këtë punë. Si është ideja që ata të paralajmërohen paraprakisht të kenë çasje në kohë për aplikim?...

Kryesuesi – Në çoftëse më lejohet të përgjigjem në pyetjen e zonjës Shqipe; Ne në takimet e mëhershme kemi planifikuar vizita në shkolla me gjithë anëtarët e komitetit për komunitete si dhe me drejtorin e DKA-së i cili ka shprehur gatishmërinë për këto vizita në terren. Mirëpo çka të bëjmë ne kur ndodhi greva dhe na pamundësoi të realizohen këto vizita.


Shqipe Kryeziu- Kryesues, kjo ka qenë para grevës, greva me 25 gusht ka filluar.

Kryesuesi – Plotësisht pajtohem me juve dhe me të gjithë ata që kanë shprehur gatishmërinë për këtë gjë, mirëpo ka qenë pushimi i nxënësve, korriku dhe gushti. Planifikimi ishte vizita në shkolla dhe jo në vendbanime. Besoj që në ditët në vijim në mënyrë elektronike do të njoftoheni për datën se kur do të mund t'i realizojmë këto vizita nëpër shkolla.

Kryesuesi – Atëherë faleminderit për pjesëmarrje, shihemi në takimin e radhës.

Mbledhja përfundoi: 11:20

Procedimhajtësi;


Albion Krasniqi

Kryesuesi i mbledhjes;


Bajram Morina

